

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Përputhshmërie, Tematik)

**“AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE
PAJISJEVE MJEKËSORE”**

Tiranë, Janar 2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Përmbajtja

Nr.	Emërtimi	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-7
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-7
3.	Konkluzion i përgjithshëm i auditimit	7-7
II	HYRJA	8-10
1.	Titulli	8-8
2.	Marrësi	8-8
3.	Qëllimi dhe Objektivat	8-8
4.	Identifikimi i çështjes	8-8
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-9
6.	Përgjegjësitë e audituesve	9-9
7.	Kriteret e vlerësimit	9-10
8.	Standardet e auditimit	10-10
9.	Metodat e auditimit	10-10
10.	Dokumentimi i auditimit	10-10
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11-36
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	11-11
2.	Përshkrim i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
	<i>Drejtimi 1: “Procedurat e ndjekura nga institucioni për dokumentimin, ruajtjen dhe qarkullimin e aktiveve në përdorim të laboratorit të kontrollit në AKBPM Tiranë.”</i>	11-20
	<i>Drejtimi 2: “Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”</i>	20-32
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	32-36
V	ANEKSE	37-38



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, më poshtë e emërtuar “AKBPM”, për periudhën për periudhën nga 01.11.2018 deri 31.08.2020 me objekt “Auditim përputhshmërie”. Auditimi tematik kishte në fokus, procedurat e ndjekura nga institucioni për dokumentimin, ruajtjen dhe qarkullimin e aktiveve në përdorim të laboratorit të kontrollit dhe masat e marra në këtë kuadër dhe i orientuar në dy drejtime kryesore, procesin e inventarizimit dhe funksionimin e sektorit të laboratorit të kontrollit. Në këtë auditim u angazhuan 3 (tre) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkluzionet përkatëse paraqiten në mënyrë më të hollësishme në pjesën e III dhe IV, të këtij Raporti Përfundimtar. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është institucion publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Veprimtaria e saj mbështetet në ligjin 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ligjin nr. 89/2014, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, të ndryshuar dhe funksionon me status të veçantë. Marrëdhëniet e punës në institucion rregullohen sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Në përfundim të procedurës audituese, akt-konstatimeve, Projekt Raportit, observacioneve të paraqitura, takimeve dypalëshe me subjektin e audituar në terren dhe takimin ballafaques në KLSH, u rekomanduan masat përkatëse për përmirësimin e situatës.

I.2 Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi paraqitet sa më poshtë:

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi rezultoi se, AKBPM është institucion përgjegjës, për kontrollin dhe analizimin e barnave, për të garantuar vendosjen në treg të barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. Njësia përgjegjëse në AKBPM për kryerjen e analizave mbi barnat është “Sektori i Laboratorit të Kontrollit”. Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një tkurrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014. Pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019. Pas kësaj periudhe institucioni nuk ka kryer më analiza dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është paralizuar tërësisht. KLSH në auditimin e kryer nga Departamenti i Performancës në KLSH në AKBPM gjatë vitit 2019, me objekt “Cilësia dhe Siguria e Barnave në Rrjetin e Hapur Farmaceutik dhe Shërbimin Spitalor” veç aspekteve të tjera ka	Drejtimi nr. 2 <i>“Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”</i> <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar</i>	E lartë	- Nga ana e AKBPM, të merren masat e nevojshme për rinisjen e punës së laboratorit të kontrollit, për të garantuar vendosjen në treg të barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën dhe përmbushjen e detyrës funksionale të institucionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

	evidentuar gjithashtu problematikën mbi numrin e ulët të analizave të kryera nga institucioni, ndërkohë që kryerja e tyre në vijim ka stopuar. Për periudhën vitet 2019 dhe në vijim institucioni ka ushtruar veprimtarinë në ambientet pranë Institutit të Shëndetit Publik si rrjedhojë e procesit të rikonstruksionit të godinës së vet. Më tej ngjarjet e jashtëzakonshme si tërmeti i 26 Nëntorit dhe Pandemia COVID-19 shpallur në fund të muajit Mars 2020 kanë patur gjithashtu ndikimin e tyre negativ në situatën mbi ambientet dhe veprimtarinë e stafit. Megjithatë, mungesa e analizave në afatgjatë ka ndikime të rëndësishme në ruajtjen e shëndetit të popullatës dhe për këtë institucioni përpara procesit të zhvendosjes dhe në vijimësi duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në garantimin e vijueshmërisë së punës së laboratorit dhe përmbushjen e detyrimit institucional mbi analizimin e barnave.			
2.	Nga auditimi rezultoi se, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në muajin Nëntor 2018 kishte filluar procesin e transferimit të veprimtarisë së saj pranë Institutit të Shëndetit Publik si rrjedhojë e nisjes së rikonstruksionit dhe shtesës të objektit ku ushtrohej veprimtaria. Ky transferim i aktiveve është shoqëruar dhe ka evidentuar disa problematika të cilat trajtohen si më poshtë. a. Institucioni nuk rezulton të ketë përmbushur detyrimin e tij për inventarizimin vjetor për periudhën ushtrimore viti 2018 si përpara transferimit ashtu dhe pas tij, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 74 dhe 75 i tij. Ndërkohë që procesi i inventarizimit për vitin ushtrimor 2019 kishte nisur në muajin Janar 2020 sipas Urdhrit të Titullarit nr. 4 dhe nr. 5 datë 08.01.2020, finalizimi i këtij procesi është realizuar në muajin Gusht 2020, kur institucioni është rikthyer pjesërisht në objektin e rikonstruktuar, pra pas rreth 7 muajsh përtej afatit të parashikuar fillimisht. Zvarritjet dhe zgjatjet në kohë të procesit të inventarizimit, cenojnë besueshmërinë e procesit si dhe krijojnë risk në mirëmenaxhimin e aktiveve të njësisë. b. Evidentohet se, transferimi i aktiveve në kuadër të ristrukturimit nga AKBPM te Instituti i Shëndetit Publik dhe anasjelltas, nuk është shoqëruar me dokumentacion të nevojshëm si, procesverbale, listë aktivesh të zhvendosura sipas datave, mjetet e transportit të përdorura, oraret e lëvizjes, personat shoqëruar, Fletë-ngarkesa, etj. Mungesa e tyre, pavarësisht faktit se në inventarizimin e fundit të kryer nga institucioni nuk rezultojnë diferenca materiale, ka krijuar mosdokumentim të procesit dhe mungesë të gjurmës së auditimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 pika 3 pika dh) dhe f) si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 34, 36, 51 e tij.	Drejtimi nr. 1 <i>“Procedurat e ndjekura nga institucioni për dokumentimin, ruajtjen dhe qarkullimin e aktiveve në përdorim të laboratorit të kontrollit në AKBPM Tiranë.”</i> <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 12-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	- Nga ana e AKBPM, të merren masat e nevojshme për kryerje të paktën një herë vit të procedurave të plota të inventarizimit si dhe për grupe të veçanta aktivesh të kryhen inventarizime më të shpeshta me qëllim verifikimin e saktësisë së veprimeve të kryera nga njësia dhe eliminimin e abuzimeve apo keqpërdorimeve të mundshme. - Titullari i AKBPM, të hartoj rregullore të veçantë në të cilën të evidentohen qartë procedurat, për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, për të siguruar mirëmenaxhimin e aktiveve dhe eliminuar keqkuptimet mbi përgjegjësinë materiale



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

	Evidentohet se, hartimi i rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari lidhur me procedurat për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike është një hap i domosdoshëm, i cili nevojitet për të përmirësuar cilësisht procesin në funksion të ruajtjes dhe dokumentimit të tyre, si dhe garantimit të efektivitetit të kontrolleve të brendshme. Kjo referuar ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 pika ç) dhe ë), si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 5,6 e vijues të tij.			
3.	- Nga auditimi rezultoi se, baza rregullative mbi të cilën bazohet veprimtaria e institucionit paraqet mangësi. Sipas bazës ligjore aktuale, konkretisht VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar, ka përcaktuar që kompetencën për miratimin Rregullores së Brendshme e ka Titullarit i institucionit i cili me Urdhrin nr. 264 datë 25.09.2017 e ka miratuar atë, ndërkohë sipas VKM-së së mësipërme dokumenti “Përshkrimet e Punës” duhet të propozohet nga Drejtori i AKBPM dhe të miratohej nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Përshkrimet e punës janë përcjellë zyrtarisht pranë ministrisë përgjegjëse me shkresën nr. 3212 prot, datë 08.05.2017 por ende nuk ka një miratim zyrtar apo shkresë për rregullim apo plotësim të tyre nga kjo e fundit. Pra aktualisht AKBPM nuk disponon një ndarje të detajuar të punës, çka ndikon dhe në ndarjen e qartë të përgjegjësi individuale për institucionin në tërësi. Kontradiktore paraqitet situata ku sipas VKM-së nr. 24, përcaktohet se, “Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Agjencisë” pra detyrat bazë mbi të cilën mbështetet puna e Agjencisë, hartohet dhe miratohet nga Drejtuesi i Institucionit ndërsa Përshkrimet e Punës të cilat në thelb janë derivat i kësaj rregullore dhe rregullojnë proceset e punës miratohen prej organit epror, ndërkohë që duhet të ishte krejt e kundërta. Në rregulloren aktuale, Titullari i institucionit përcakton jo vetëm detyrat por gjithë veprimtarinë e funksionale përfshirë masat disiplinore të punonjësve, llojet dhe procedurat për dhënien e tyre. Përcaktimi, hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “konflikt interesi” i cili mund të ndikoj në paanshmërinë dhe objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm. Miratimi i rregullave të brendshme të veprimtarisë duhet të bazohet rregullisht në dispozitat e ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij.	Drejtimi nr. 2 <i>“Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”</i> <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	- Nga ana e AKBPM, referuar VKM nr. 24, datë 14.01.2015, pika 3 gërma dh) e tij, ti kërkohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për propozimin e ndryshimeve të nevojshme në këtë vendim, për miratimin nga organi epror të të gjithë rregullave të brendshme të funksionimit dhe sjelljes, konform përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

4.	Nga auditimi rezultoi se, AKBPM është institucion përgjegjës, i cili ka për kompetencë kontrollin cilësor të barnave për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. Njësia përgjegjëse në AKBPM për kryerjen e analizave mbi barnat është “Sektori i Laboratorit të Kontrollit”. Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një tkurrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014, pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019 por më pas institucioni nuk ka vijuar kryerjen e tyre dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është ndërprerë tërësisht. Në vijim, punonjësit janë ngarkuar me detyra plotësuese mbi përgatitje materiale mbi procesin e akreditimit i cili pavarësisht vlerës së shtuar që sjell, nuk justifikon moskryerjen e analizave mbi barnat, që është objekti kryesor i punës së veprimtarisë së sektorit. Vlera e shpenzuar nga institucioni për 18 punonjësit pjesë e “Sektorit të Laboratorit të Kontrollit”, në fond page dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën Janar 2019-Gusht 2020 llogaritet në vlerën rreth 26.3 milion lekë, e cila në mungesë të përmbushjes së detyrës kryesore të punës së këtij sektori në analizimin e barnave, përbën shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efikasitetit, dhe ekonomicitetit të fondeve publike.	Drejtimi nr. 2 <i>“Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”</i> <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar</i>	E lartë	- Nga ana e AKBPM, pavarësisht procesit të akreditimit, të merren masat e nevojshme për rinisjen e punës së laboratorit për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën duke garantuar gjithashtu përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore.
5.	Nga auditimi rezultoi se, në problematikat e evidentuara në AKBPM mbi mungesën e “Përshkrimeve të Punës” të miratuara, stafit të lartë drejtues, mangësitë mbi menaxhimin e aktiveve, ndërprerjen e kryerjes së analizave mbi barnat, nuk evidentohet roli mbikëqyrës i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si organi epror, referuar kjo dispozitave të ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 22 pika 1, si dhe neni 23 pika 1 e tij. Konstatohet gjithashtu se, megjithëse Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 184 datë 09.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e kontrollit për veprimtarinë e agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore, në zbatimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë nga kjo agjenci”, ka miratuar krijimin e “Njesisë së Posaçme” për kontrollin periodik dhe sa herë të shihet e nevojshme të AKBPM, prej më tepër se 4 (katër) vitesh nga miratimi i këtij vendimi, MSHMS nuk rezultoi ta ketë bërë efektive duke ushtruar kontrolle me këtë strukturë, në kundërshtim me parashikimet në këtë vendim. Sa më lartë, situata paraqet nevojën imediate për përmbushjen e rolit të MSHMS si organ epror në	Drejtimi nr. 2 <i>“Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”</i> <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar</i>	E lartë	- Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masat e nevojshme për të bërë funksionale këtë strukturë dhe për të përmbushur kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave. - Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masat e nevojshme për plotësimin e organikës së AKBPM me personelin e nevojshëm konform strukturës së miratuar dhe bazës ligjore përkatëse.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

mirëfunksionimin institucioneve, realizimin e objektivave të miratuar, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimin financiar, çka nuk përkon në rastin konkret. Sa më lartë, situata paraqet nevojën imediate për përmbushjen e rolit të MSHMS si organ epror në mirëfunksionimin institucioneve, realizimin e objektivave të miratuar ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimin financiar, çka nuk përkon në rastin konkret.			
---	--	--	--

I.3. Konkluzioni i Përgjithshëm

Nga auditimi rezultoi se, AKBPM paraqet mangësi në disa prej aspekteve të veprimtarisë së saj dhe konkretisht:

-Institucioni për një periudhë rreth 11 muaj nuk ka kryer analiza të barnave të cilat importohen/prodhohen në vend, lëndëve të para farmaceutike, barnave sipas sondazheve në treg etj, çka nuk garanton sigurinë dhe cilësisë e kërkuar të barnave të ofruara në treg. Numri i ulët i analizave gjatë vitit 2019 dhe mungesa e tyre tërësisht gjatë vitit 2020 ka bërë që shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve, për personelin e Sektorit të Laboratorit, në vlerën rreth 26.3 milion lekë, të jenë kryer jo në përputhje me parimet eficientë, dhe efektivitetit, të fondeve publike. Sipas VKM nr. 24, datë 14.01.2015 miratimi i Rregullores së Brendshme ose detyrave bazë bëhet nga Titullari i institucionit, ndërsa miratimi i dokumentit “Përshkrime Pune” pra proceseve të përditshme të punës bëhet nga ministri përgjegjës, kjo mënyrë miratimi vlerësohet e papërshtatshme pasi, miratimi i rregullave të brendshme nga vet titullari zbatues i tyre përbën në parim një “konflikt interesi”, çka mund të ndikoj në paanshmërinë dhe objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare. Institucioni evidenton nevojën për hartimin e një rregullore specifike e cila të evidentoj qartë procedurat dhe përgjegjësit individuale, për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njesisë publike, për të siguruar mirëmenaxhimin e aktiveve dhe eliminuar keqkuptimet mbi përgjegjësinë materiale. MSHMS si organ emërtese për punësimet e AKBPM nuk rezulton të ketë plotësuar ende strukturën me personelin e plotë ku evidentohet mungesa e dy pozicioneve kyçe përkatësisht Zv. Drejtorëve Teknik dhe atij Ekonomik. Prej saj nuk është miratuar dhe as kthyer për plotësim dokumentin “Përshkrime Pune” prej vitit 2017, çka ka bërë që proceset e punës të AKBPM prej një kohe të gjatë të vijojnë në mungesë të tyre. Mungon roli i saj mbikëqyrës mbi veprimtarinë e institucionit, si edhe prej më tepër se 4 (katër) vitesh nuk është vënë ende në funksion “Njësia e Posaçme” e miratuar me VKM nr. 184 datë 09.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e kontrollit për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”. Mangësitë e përmendura më lartë kanë ndikim të rëndësishëm në veprimtarinë shtetërore dhe shëndetin e qytetarëve dhe evidentojnë nevojën për marrjen e masave të menjëhershme si nga AKBPM ashtu edhe nga MSHMS, në këtë drejtim.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, më poshtë e emërtuar “AKBPM”, në bazë të programit të auditimit tematik të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 812/1 prot, datë 01.09.2020, për periudhën e auditimit nga data 01.11.2018 deri në 31.08.2020, me afat auditimi nga data 01.09.2020 deri më 20.09.2020, dhe lloj auditimi “Auditim Përputhshmërie”, i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.X, Përgjegjës grupi
2. R.L, Auditues
3. H.K, Auditues

Titulli:

Raport Përfundimtar i Auditimit tematik, “Mbi Përputhshmërinë” në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Tiranë.

Marrësi:

Ky Raport Përfundimtar i adresohet Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Objektivat dhe qëllimi:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Vlerësimi i saktësisë së informacioneve në aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, nëse janë zbatuar parimet e profesionalizmit, të efikasitetit, dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Përbushja e qëllimit të auditimit në, dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë “Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”. Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale e administrative, të kryera me kriteret dhe kërkesat e legjisllacionit në fuqi. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “AKBPM”, për periudhën objekt auditimi nga 01.11.2018 deri më 31.08.2020, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni dhe konkretisht: Procedurat e ndjekura nga institucioni për dokumentimin, ruajtjen dhe qarkullimin e aktiveve në përdorim të laboratorit të kontrollit dhe masat e marra në këtë kuadër.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjisllacionin në fuqi:

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-*Nëpunësi autorizues* është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale .

-*Nëpunës zbatues*, i caktuar si është personi përgjegjës sipas kuadrit normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të treguesve financiarë.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e Përputhshmërisë

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticismin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500/ISA 300*).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivit.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Kriteret e vlerësimit:

-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 89/2014, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, të ndryshuar, i ndryshuar;

-Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-VKM nr. 24 datë 14.01.2015 “Për Miratimin e Strukturës dhe Mënyrës së Funkcionimit e Organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”; i ndryshuar;

-VKM nr. 184 datë 09.03.2016 “Për Përcaktimin e Rregullave për Ushtrimin e Kontrollit për Veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, në Zbatimin e Detyrave dhe Ushtrimin e Përgjegjësisë nga kjo Agjenci”;

-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;

-Rregullore e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AKBPM”, nr. 264 prot, datë 25.09.2017;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

-Akte të tjera ligjore, nënligjore, e rregullative, të detyrueshme për zbatim:

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

- Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI);
- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” ku përcaktohen parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”;
- ISSAI 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t”, si dhe
- ISSAI 30 “Kodi i Etikës:

Metodat e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve. Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në;

-*Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.*

-*Kontrolli i vlerësimit për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare.*

-*Verifikimi i transaksioneve duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.*

-*Inspektim fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.*

-*Intervistimi i personelit që ka patur role specifike.*

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-konstatimeve të mbajtur, Projekt Raportit të Auditimit, observacioneve të paraqitura, takimeve dypalëshe me subjektin e audituar në terren dhe takimin ballafaques në KLSH, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është institucion publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Agjencia funksionon me status të veçantë. Organizimi, struktura dhe mënyra e funksionimit të saj rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 24 datë 14.01.2015 dhe është përgjegjëse për analizën dhe kontrollin e barnave, për dhënien e autorizimit për tregtim, për inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, për farmako-vigjilencën si dhe për administrimin e standardeve të pajisjeve mjekësore. Veprimtaria e saj mbështetet gjithashtu në ligjin 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ligjin nr. 89/2014, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, të ndryshuar. Marrëdhëniet e punës në institucion rregullohen sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Mënyra dhe procedurat e punësimit, lëvizjet dhe transferimi i stafit të Agjencisë miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Agjencia drejtohet Drejtori i cili miraton Rregulloren e Brendshme të institucionit, ndërsa përshkrimet e punës për të gjithë punonjësit miratohen nga ministri përgjegjës. Aktualisht rregullorja e brendshme në fuqi është miratuar nga Drejtori i AKBPM dhe mban nr. 264 prot, datë 25.09.2017 ndërsa Rregullorja “Mbi mënyrën dhe procedurat e punësimit, lëvizjet dhe transferimet e personelit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, është miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 201 datë 30.04.2015.

Drejtimi 1: “Procedurat e ndjekura nga institucioni për dokumentimin, ruajtjen dhe qarkullimin e aktiveve në përdorim të laboratorit të kontrollit në AKBPM Tiranë”

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- Praktikë dokumentacioni për inventarizimin vjetor (viti 2017) i kryer nga institucioni për Laboratorin e Kontrollit.
- Praktikë dokumentacioni për inventarizimin vjetor (viti 2019) i kryer nga institucioni për aktivet.
- Dokument Akt-Dorëzimi sheshi ndërtimi datë 20.12.2018 mbajtur nga palët, në vijim të Kontratë Sipërmarrje nr. 3875/99 prot, datë 26.10.2018 e lidhur midis AKBPM dhe subjektit fitues për “Rikonstruksionin dhe shtesë të godinës” ku ushtron veprimtarinë institucioni.
- Pasqyrat Financiare vjetore viti 2019.
- Dokumentacion “Fletë-dalje magazine” mbi marrjen në dorëzim të aktiveve të laboratorit prej periudhës 2008/12 dhe në vijim.
- Dokumentacion mbi dorëzimin dhe marrjen e detyrës së pozicionit “Shef Sektori” në Laboratorin e Kontrollit.
- Korrepondencë e AKBPM me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Institutin e Shëndetit Publik për ambiente të lira në kuadër të rikonstruksionit.
- Të tjera akte, ligjore, nënligjore, administrative etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi:

Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i qarkullimit të tyre

Nga auditimi rezultoi se, AKBPM i ka të regjistruara aktivet në kontabilitetin buxhetor sipas klasave dhe kartelave përkatëse. Për këtë ne u bazuam prej ballafaqimit të të dhënave financiare të deklaruara në pasqyrat Financiare të Vitit 2019 të depozituara pranë Degës së Thesarit Tiranë, me nr. 21/2 prot, datë 30.03.2020 me treguesit përmbledhës sipas kartelave të inventarizimit të kryer nga institucioni, pjesë e regjistrimit të aktiveve, proces i nisur në muajin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Janar 2020 dhe i përmbyllur në muajin Gusht 2020. Sipas dokumentacionit vënë në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe sqarimeve lidhur me to, institucioni nuk disponon program financiar të dedikuar për regjistrimin e aktiveve financiare e materiale dhe veprimet e kryera me to, por regjistrimet dhe veprimet e kryera për aktivet mbahen në dokumente dhe përpunohen në programin Excel.

-Në muajin Nëntor 2018 si rrjedhojë e rikonstruksionit dhe shtesës për godinën në të cilën ushtronte veprimtarinë institucioni, AKBPM i është drejtuar MSHMS në rolin e organit epror me kërkesë për ambiente të lira, ku kjo e fundit nëpërmjet shkresës së saj nr. 6357/1 datë 26.11.2018 ka informuar agjencinë për marrjen e masave për transferimin në ambientet pranë ISHP si dhe në pamundësi të akomodimit të gjenden ambiente të tjera me qera.

Në kuadër të këtij transferimi drejtuesi i Institucionit ka nxjerr disa urdhra të brendshëm për marrjen e masave dhe zhvendosjen e vlerave dokumentare dhe materiale të institucionit. Përkatësisht Udhurat e Brendshëm të Drejtorit nr. 297 datë 07.11.2018, “Për marrjen e masave dhe organizimin e punës për lirim të ambienteve të institucionit”, nr. 302 datë 12.11.2018 “Për zhvendosjen e vlerave dokumentare dhe materiale të institucionit” dhe nr. 307 datë 16.11.2018, “Për ngritjen e grupit të punës për aktivet në ambientet e përbashkëta të institucionit”. Në dy urdhrat e parë nr. 297/302, urdhërohet i gjithë personeli i AKBPM i cili ka në ngarkim/ose përdorim aktivet sipas vendit të punës të angazhohet në procesin e transferimit pa cënuar vijueshmërinë e punës së tyre. Urdhërohen gjithashtu Shefat e sektorit për organizimin e punës për zhvendosjen deri në përfundim të rikonstruksionit të godinës si dhe ngarkimin e tyre me përgjegjësinë për lëvizjen dhe shoqërimin e vlerave dokumentare dhe materiale deri në përfundim të sistemit.

Nga auditimi rezultoi se, institucioni nuk disponon dokumentacion mbi procesin e transferimit të aktiveve nga AKBPM në ISHP si, procesverbale, listë aktivesh të zhvendosura sipas datave, mjetet e transportit të përdorura, oraret e lëvizjes, personat shoqëruar, Fletë-ngarkesa, etj. Mungesa e këtyre dokumentave vërtetues, pavarësisht faktit se në inventarizimin e fundit të kryer nga institucioni nuk rezultojnë diferenca materiale, kanë krijuar mosdokumentim në atë çfarë është zhvendosur, kur është zhvendosur dhe kush ka mbikëqyrur lëvizjen në kundërshtim me, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 34, 36, 51 e tij ku përcaktohet se,

34. Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.

*51. Transportuesi ka përgjegjësinë e dergimit të aktiveve nga derguesi tek marresi brenda afatit dhe pa demtim. **Transporti i aktiveve kryhet në baze të dokumentave përkatëse që janë plotësuar për çdo dergese dhe në përputhje me urdherin dhe dispozitat e caktuara. Dokumenti baze që konfirmon transportin e aktiveve është Fletë-ngarkesa...***



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Pra në këtë rast mungon plotësisht gjurma e auditimit. Mangësitë dhe të metat e procesit bien në kundërshtim me, kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 pika 3 pika *dh*) dhe *f*) e saj, ku përcaktohet se,

3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:

dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi;

f) ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar;

Mangësitë kanë krijuar problematikë edhe për faktin se një pjesë e Laboratorit të Kontrollit është magazinuar në një ambient të veçantë në AKBPM ndërsa pjesa tjetër është transferuar në ISHP dhe kjo ndarje nuk i është nënshtruar një inventarizimi për të patur një informacion të plotë mbi aktivet dhe vendodhjen e tyre. Kjo procedurë vlen edhe për procesin e kthimit në AKBPM të këtyre aktiveve pas përfundimit të rikonstruksionit, ku një pjesë e aktiveve janë rikthyer ndërsa pjesa tjetër (e pa evidentuar me listë) vijon ende të jetë në ISHP në mirëbesim mes institucioneve por pa një akt të dokumentuar mbi aktivet që ruhen dhe mbrohen nga ISHP.

Pavarësisht detyrave të ngarkuara ndaj personelit apo Shefave të Sektorit, procedurat duhet të mbikëqyreshin prej Nëpunësit Zbatues të institucionit. Pra mangësia e përfshirjes së kësaj hallke mjaft të rëndësishme vihet re si në urdhrin e hartuar ashtu edhe në procedurën e kryer në mungesë të gjurmës së auditimit.

Masat e marra për ruajtjen e aktiveve

Pas marrjes në dorëzim të aktiveve dhe hyrjes në magazinë, procedura ka vijuar me dhënien në përgjegjësi të aktivitetit. Nga ana e institucionit është vepruar duke dhënë në përgjegjësi materiale aktivet në përdorim personal, ndërsa për aktivet në përdorim të përbashkët të stafit në sektor, është pikërisht stafi i sektorit të cilit i kërkohet përgjegjësi materiale mbi to në AKBPM. Përgjegjësi materiale e personelit parashikohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 10, 12, 13 të tij ku përcaktohet se,

10. Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka nën përgjegjësi.

12. Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktësi në dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.

13. Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nëpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Institucioni nuk disponon një dokument të miratuar mbi rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur nga stafi për, marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike i cili do të qartësonte më tej detyrimin e punonjësve, megjithëse ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kanë parashikuar në mënyrë të qartë se,

8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore

ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;

ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Po kështu UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, të ndryshuar pika 5, 6 e vijues të tij kërkojnë hartimin e rregullave të hollësishme të cilat do të garantonin që çdo individ të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësive të cilat do të përbënin udhërrëfyesin për zbatimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara sipas pikave të këtij udhëzimi, ku përcaktohet se,

5. Titullari i njësive publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

6. Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësive publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Cdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësive.

Hartimi i rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari, është një hap i domosdoshëm për kryerjen e procedura të inventarizimit në vijim në funksion të objektivit për të cilin ky proces realizohet.

Kryerja e procedurave të inventarizimit të pasurisë shetërore

Nga auditimi rezultoi se, institucioni ka kryer procedurën e inventarizimit për efekt të Pasqyrave Financiare të vitit buxhetor 2017 sipas Urdhrit të Brendshëm nr. 309 datë 11.12.2017 “Mbi Inventarizimin”, përfunduar prej grupit të punës dhe relatuar Drejtorit të AKBPM me shkresën nr. 9730/1 datë 29.12.2017, sipas dokumentacionit shoqërues të së cilës nuk janë evidentuar diferenca materiale.

Për vitin ushtrimor 2018 procesi i inventarizimit nuk është zhvilluar çka përkon me procesin e rikonstruksionit dhe zhvendosjen e tij pranë ISHP, ku një pjesë e aktiveve të laboratorit ishin magazinuar dhe lënë pranë godinës që po rikonstruktohej të AKBPM.

Referuar sa më lartë, moskryerja e procesit pavarësisht kushteve ka cënuar procedurën e parashikuar nga aktet ligjore, por nuk ka krijuar efekte materiale pasi në inventarizimin pasardhës nuk janë evidentuar diferenca materiale.

Mangësitë bien ndesh me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 74, 75 të tij ku përcaktohet se,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

74. Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

*75. Titullari i njesise publike, kur ka dyshime per mashtrime, abuzime, keqperdorime, vjedhje apo grabitje te aktiveve apo te nje pjese te tyre, ose qofte edhe per te vertetuar sakesine e veprimeve ligjore per nje periudhe kohore, **mund te urdherojne kryrjen e inventarizimeve të plotë ose të pjesshme të tyre, pa kufizim në numër, jashtë afateve të parapara të inventarizimit të aktiveve të inventarizimit të aktiveve.***

-Për vitin ushtrimor 2019 procedura e inventarizimit ka filluar me Urdhrat e Brendshëm nr. 3 datë 08.01.2020 “Mbi inventarizimin e vlerave materiale të magazinës”, nr. 4 datë 08.01.2020, “Mbi inventarizimin e barnave gjendje në magazinë”, nr. 5 datë 08.01.2020 “Mbi inventarizimin e aktiveve materiale, jomateriale e financiare”. Afati i përfundimit të inventarizimeve është vendosur data 23.01.2020. Ecuria e procesit ka vijuar si më poshtë:

-Me shkresën nr. 22/4 prot, datë 22.01.2020 grupi i inventarizimit të materialeve në magazinë referuar urdhrin nr. 3, ka përfunduar dhe relatuar procedurën e inventarizimit pa diferenca materiale.

-Me Urdhrin e Brendshëm nr. 41 dhe nr. 42 datë 24.02.2020 prej Titullarit janë dhënë masa disiplinore “Tërheqje vëmendje” ndaj kryetarëve të dy komisioneve të cilët nuk kishin përfunduar detyrën në afat.

-Me shkresën nr. 22/18 prot, datë 02.03.2020 grupi i inventarizimit të barnave mjekësore gjendje në magazinë referuar urdhrin nr. 4, ka përfunduar dhe relatuar procedurën e inventarizimit pa diferenca materiale.

-Nga data 28.02.2020 deri më datë 05.06.2020 kanë vijuar shkresat midis komisionit të inventarizimit sipas urdhrin nr.5, Shefes së Sektorit të Laboratorit dhe Titullarit të institucionit mbi disponueshmërinë, procedurën, si dhe marrjen nën përgjegjësi të aktiveve të lëna pranë AKBPM gjatë transferimit si dhe janë kryer ballafaqimet mes tyre.

-Me Urdhrin e Brendshëm nr. 72 datë 05.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të aktiveve” Titullari i institucionit ka ngritur grupin e punës për inventarizimin dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të cilat i përkasin Laboratorit të Kontrollit në ambientet e rikonstruktura, inventarizim i cili është parashikuar të kryhet në prani edhe të komisionit të inventarizimit, në funksion të përmbylljes së gjithë procesit konform urdhrin nr. 5 cituar më lartë. Afati për zbatimin e urdhrin është data 09.06.2020, i cili nuk është zbatuar. Nga ana e Shefes së Sektorit është informuar Titullari mbi këtë moszbatim dhe po njëjloj është vepruar nga ana e anëtarëve të grupit si dhe nga grupi i ngritur për inventarizimin referuar urdhrin nr.5. Pretendimet e drejtueses së sektorit kanë të bëjnë me mosdorëzimin e çelësit me procesverbal. Ndërkohë që anëtarët e grupit kanë paraqitur gatishmërinë për mbylljen e procesit por kanë hasur si pengesë qëndrimin e shefes së sektorit në cilësinë e Kryetarit të Grupit. Referuar situatës nuk disponohet një procesverbal dorëzimi të çelësit të ambientit të përdorur për magazinim të përkohshëm si dhe një listë e aktiveve të depozituara në ruajtje të firmës ndërtuese. Mungesa e tyre si dhe shpjegimet kontradiktore të palëve të përfshira evidentojnë qartë nevojën e gjurmës së auditimit në rastin konkret. Pajisjet e laboratorit sipas dokumentacionit të paraqitur janë marrë fillimisht në dorëzim nga ish shefja e sektorit të laboratorit por me ndryshimet e ndodhura në këtë pozicion pune referuar Urdhrin të Titullarit nr. 112 datë 04.04.2018 ato nuk janë transferuar tek drejtuesi i ri i sektorit, ndërkohë që me dorëzimin e detyrës janë transferuar vetëm pajisjet e zyrës por jo ato të punës. Kjo me pretendimin se ato janë pjesë e kartelës së përgjithshme të ambientit të punës në ambientet ku punon stafi laboratorit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Kryerja e inventarizimit të pjesshëm është një e drejtë legjitime e Titullarit të Institucionit e cila parashikohet në pikat 75 dhe 77 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, të ndryshuar dhe si e tillë ajo duhet të zbatohet nga ana e komisionit për marrjen në dorëzim të përbërë nga 14 punonjës pjesë e stafit të Laboratorit. Komisioni mund të kërkonte bashkëpunimin edhe të Nëpunësit Zbatues për të vënë në dispozicion rregjistrin e aktiveve të njësisë që ndodheshin në ambientet e magazinimit në ndërtesën e rikonstruktuar, pasi për pjesën tjetër të aktiveve në ISHP ishte përfunduar inventarizimi. Mund të kërkohej përgjegjësia materiale e aktiveve sipas fletëdaljeve deri në këtë fazë për përmbylljen e evidentimit dhe marrjen në dorëzim të aktiveve , etj.

Lidhur me funksionalitetin e tyre nga personat e ngarkuar mund të bëheshin shënimet përkatëse në relacion shoqërues dhe jo të bllokohej marrja në dorëzim dhe të zvarritej kryerja e inventarizimit për rreth gjashtë muaj.

-Me shkresën nr. 22/31 prot, datë 09.07.2020 janë njoftuar anëtarët e grupit të Urdhrit nr. 72 si dhe Komisionit të inventarizimit të aktiveve të laboratorit sipas Urdhrit nr.5 më sipër të përfundojnë procesin deri më datë 13.07.2020.

-Me shkresën nr. 22/34 grupi i inventarizimit të urdhrit nr. 5 ka kërkuar zgjatje të afatit për mbylljen e tij.

-Me relacionin nr. 22/34 datë 14.07.2020 u relatua mbi aktivet e laboratorit në AKBPM.

-Me relacionin nr. 22/35 datë 27.08.2020 u relatua mbi aktivet totale të laboratorit.

-Me relacionin nr. 22/36 datë 28.08.2020 u përmbyll procesi i inventarizimit pa diferenca inventariale. Pra në të gjithë lëvizjen nga AKBPM-ISHP-pjesërisht AKBPM nuk paraqiten diferenca. Në praktikën përmbyllëse evidentohet gjithashtu të metat dhe mangësi si vijon:

Mungon përgjegjësia materiale për kartelën nr. 25 dhe 26 “Për ambientet e përbashkëta”, kartelën nr. 27 “ 2 Automjete”, Kartelën nr. 28 “ 1 Automjet”, Kartelën nr. 30 “ 1 Automjet” të cilat duhet tu ngarkohen në përgjegjësi materiale personave përgjegjës.

Procedura e inventarizimit është zgjatur në kohë duke vënë në diskutim kredibilitetin e procesit dhe duke riskuar atë. Në këtë proces personeli është gjendur në situatë jo të favorshme edhe për shkak të pandemisë Covid-19, por edhe për detyrimet e tyre funksionale. Ndjeshmëria dhe rëndësia e aktiveve të kësaj agjencie paraqet nevojën imediate për, hartimin e rregullave mjaft të qarta për personelin, si për marrjen në dorëzim të aktiveve individuale/të përbashkëta në përdorim dhe veprimet lidhur me to, të dokumentuara dhe rakorduara nëpërmjet nëpunësit zbatues të institucionit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

-Znj. N.S me detyrë, Drejtori i AKBPM/NA.

Për mosfillimin e procedurave të inventarizimit vjetor të aktiveve për vitin ushtrimor 2018, mosmarrjen e masave të nevojshme për përmbylljen në kohë të procesit të inventarizimit për vitin 2019, mungesën e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 pika 9, 16, 20, neni 8, neni 9 e vijues si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

-Znj. F.D me detyrë, Shef i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse/NZ.

Për disa të meta e mangësi në përmbylljen e detyrave në rolin e Nëpunësit Zbatues, lidhur me mosdokumentimin e qarkullimit të aktiveve të institucionit gjatë transferimit dhe mungesë të gjurmës së auditimit si dhe mungesën e përgjegjësit material për disa aktive të evidentuara, referuar, Kontratës individuale të punës lidhur mes palëve, Rregullores së Brendshme të AKBPM miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 264 datë 25.09.2017, ligjit nr. 10296 datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 pika 15, 19, 20, 26, neni 12 e vijues si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

-Znj. M.K me detyrë, Shef i Sektorit të Laboratorit.

-Për moszbatim të Urdhrit nr. 72 datë 05.06.2020 të Titullarit të Institucionit, mbi marrjen në dorëzim të aktiveve të Sektorit të Laboratorit, dhe zvarritjen e procesit të inventarizimit.

Nga subjekti i audituar, znj. N.S, znj. F.Z dhe znj. M.R, është paraqitur observacioni lidhur me Projektraportin, i regjistruar në AKBPM me nr. 5950/11 prot, administruar në KLSH me nr.812/8, datë 22.12.2020, ku prej përfaqësuesve të subjektit janë shprehur objeksionet si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit:

1-Në të gjitha aktet e mësipërme ligjore, si dhe në funksion të zakoneve profesionale të aplikuara dhe zbatuara nga Shefi i Laboratorit të Kontrollit, si dhe bazuar në faktet dhe provat që po ju paraqesim është e provuar plotësisht marrja përsipër e detyrimeve sipas natyrës së punës së pranuar dhe zbatuar nga Shefi i Laboratorit. Për rrjedhojë kërkojmë që të përcaktohet nga ana juaj në Raportin Përfundimtar kjo lloj “Përgjegjësie Funksionale” për Shefin e Laboratorit bazuar në dispozitat ligjor dhe nënligjore në fuqi...

2-Në lidhje me “Përgjegjësinë Funksionale” dhe “Përgjegjësinë Materiale” që ka dhe duhet të ketë Shefi i Laboratorit të Kontrollit, të cilat nuk janë konstatuar dhe nuk janë përcaktuar nga grupi i auditimit sipas gjetjes 1/c, gërma A “Masa organizative”, është një rekomandim që kërkohet për të dubluar aktet ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura në lidhje me “Përgjegjësinë funksionale” dhe “Përgjegjësinë Materiale” të Shefes së Laboratorit.

3-Në lidhje me gjetjen 1/b, gërma A “Masa organizative”, që ka të bëjë me “transferimin e aktiveve në kuadër të ristrukturimit nga AKBPM të ish dhe anasjelltas, pasi nuk ishin të shoqëruara me dokumentacion të nevojshëm si procesverbale, listë aktivesh, mjetet e përdorura, oraret e lëvizjes, personat shoqëruar, fletë ngarkesa etj....”...kjo gjetje nuk bazohet në ligj dhe në fakt pasi dispozitat nënligjore të këtij akti nuk e parashikojnë këtë fakt..

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Në lidhje me pikat 1 dhe 2 ku kërkohet evidentim i përgjegjësisë së Shefes së Sektorit sqarojmë se, përgjegjësitë për këtë punonjë të institucionit nga ana jonë janë evidentuar dhe trajtuar hollësisht jo vetëm sa i përket detyrimeve manaxheriale por edhe detyrave të ngarkuara mbi zgjatjen e inventarizimit. Mangësitë e konstatuara nga ana e grupit të auditimit, rezultuan që kanë vijuar për një kohë të gjatë në AKBPM, ndërkohë për zgjidhjen e tyre nuk janë marrë masa në kohë prej Titullarit të Institucionit dhe situata ka vijuar të mbetet e pazgjidhur në kohë. Ju keni qenë plotësisht të qartë mbi detyrimet e këtij punonjësi dhe keni evidentuar moszbatim nga ana e tij për një kohë të gjatë. Vlerësimi institucional mbi mospërmblidhjen e detyrimeve të punonjësit duhet të ishte referuar pikërisht sipas përcaktimeve të Kontratës së Punës, Kodit të Punës, dhe Rregullores së Brendshme të Institucionit që po na i paraqisni, por të paezauruara prej Jush.

-Në lidhje me pikën 3 më sipër sqarojmë nuk mund të devijoj përgjegjësinë mbi lëvizjen apo transferimin e aktiveve duke dhënë argumente jo në përputhje me aktet ligjore kur Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 34, 36, 51 i tij, por jo vetëm, parashikojnë qartë mënyrën e dokumentimit të lëvizjes së aktiveve.

Sa më sipër, observacioni nuk paraqet të dhëna apo argument shtesë të vlefshëm mbi çështjet e trajtuara në material e si i tillë ai nuk merret në konsideratë nga ana jonë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.812/2, datë 28.09.2020 nga znj. M.K, ku në mënyrë të përmbledhur lidhur me Akt-Konstatimin nr. 1 janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

...Pavarësisht vështirësive dhe procesi i inventarizimit në këtë rast nuk e ka ndërprerë apo penguar punën e laboratorit të Kontrollit.... Laboratori edhe aktualisht nuk po kryen analiza, pra inventarizimi nuk ka ndikuar në funksionimin e tij...Për sa i përket komunikimeve të mija unë i jam përgjigjur kërkesave të komisionit të inventarit në respektim të UMF nr. 30...

Nuk është përgjegjësi e Shefes së Laboratorit, trajnimi i personelit që përfshihet në procesin e inventarizimit apo is zbatohet UMF nr.30, datë 27.12.2011...Ajo që vlen të theksohet se nuk mund të firmos aparatura që nuk janë vënë asnjëherë në punë, të konstatuara këto nga grupet e punës të ngritura në AKBPM...Zhvendosja për në ambientet e rikonstruara përsërit të njëjtën situatë pa plan zhvendosje thjesht me komunikim verbal..Për sa më sipër nuk mendoj se kam përgjegjësi në lidhje me procesin e inventarizimit, sipas trajtimeve në Akt-Konstatim

....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me ecurinë e punës në laborator sqarojmë se, kryerja e analizave është ndërprerë prej muajit Tetor 2019 pra përpara nisjes së procesit të inventarizimit. Sa i përket procesit të inventarizimit evidentohet mospërmblidhje e kërkesave të Urdhrit të Titullarit nr. 72 datë 05.06.2020. Shkresat e shpeshta kërkesë-përgjigje nuk legjitimojnë vonesat e krijuara pasi ky proces është përfunduar nga grupi i caktuar. Mbi aparaturat që trajtoni si të pavëna në punë si dhe në kushtet e magazinimit të tyre, kjo nuk duhet të pengonte procesin e inventarizimit por njëjloj si në proceset e mëparëshme vlerësimi i funksionalitetit mund të kërkohej dhe duhet të bëhet menjëherë me krijimin e kushteve normale për këtë proces. Mbi zhvendosjen e aktiveve ekziston urdhri i titullarit nr. 297 datë 07.11.2018 dhe nr.302 datë 12.11.2018 ku ngarkohet personeli dhe shefat e sektorit për zbatimin e tij. Të metat dhe mangësitë mbi procesin e zhvendosjes janë trajtuar hollësisht në akt-konstatimin e mbajtur si dhe në Projektraportin e auditimit. Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë nga ana jonë.

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nga znj. N.S dhe znj. F.D, regjistruar në AKBPM me nr. 5950/6 prot, administruar në KLSH me nr.812/3, datë 30.09.2020, ku janë shprehur objeksionet lidhur me Akt-Konstatimin nr. 1 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

...regjistrimet e aktiveve janë të organizuara në format Excel për shkak se fondi llog.231 me objekt “Soft financa” nuk është miratuar ende nga ...MSHMS...

...institucioni nuk disponon dokumentacion mbi procesin e transferimit...Rezulton se kjo është një përgjegjësi e dokumentuar me anë të Urdhrave përkatës të Titullarit të Institucionit por nga ana e Shefave të Sektorit dhe personelit nuk është relatuar në lidhje me ecurinë e zhvendosjes...prandaj pretendimi se nga AKBPM nuk janë zbatuar përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.11.2011, nuk qëndron për shkak se në rastin konkret: nuk jemi para veprimeve ekonomike, por kemi të bëjmë me veprime administrative....pikat 34,35,36 nuk janë veprime ekonomike që evidentojnë sjelljen dhe ndryshimet e pasurisë (veprime hyrje-dalje)...



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

-Në lidhje me konstatimin se, ...mungon plotësisht gjurma e auditimit....ky pretendim nuk qëndron....Institucioni nuk ka strukturë auditit të brendshëm kështu që sistemi i menaxhimit, ..NA.. është organizuar dhe funksionon mbi bazën e zbatimit të urdhrave...

-Për më tepër konstatimi juaj se “një pjesë e laboratorit të kontrollit është magazinuar në një ambient të vecantë në AKBPM” ...në këtë rast ka të bëjë me moskryerjen e detyrave të Shefit të Laboratorit i cili nën përgjegjësinë e tij ka vendosur ti lërë aktivet në ambientet e Agjencisë...Procesi i Zhvendosjes ka qenë nën mbikëqyrjen e ..Zv Drejtori Ekonomik i Agjencisë.

-Sqarojmë se, për aktive “pajisje laboratorit” nuk janë kryer transaksione financiare prej vitit 2012. Këto aktive prej vitit 2012 deri në vitin 2020 janë në përgjegjësi materiale të Shefit të Sektorit dhe punonjësve të laboratorit, sipas kartelave të inventarit të nënshkruara nga personat përgjegjës...

-Sqarojmë se procedura e inventarizimit është zgjatur në kohë, jo për mangësi procedurale por të presionit të ushtruar nga ana shefja e Laboratorit të Kontrollit..

-Për më tepër me anë të kartelave të inventarit provohet përgjegjësia e përbashkët në administrimi dhe ruajtjen e aktiveve në ambientet e përbashkëta. Lidhur me kartelën nr. 27,28 dhe 30 që i përket automjeteve ao janë evidentuar nga Komisoni sipas kartelës së vitit 2017 por nuk janë në gjendje pune dhe janë në process vlerësimi për nxjerrje jashtë përdorimit..

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me mbajtjen e regjistrimeve, nga ana jonë trajtohet mënyra aktuale e mbajtjes së regjistrimeve por nuk trajtohet nevoja për program të dedikuar për regjistrimet në kontabilitet, çka është kompetencë e institucionit në varësi të domsodoshmërisë dhe parashikimeve buxhetore.

Mungesa e dokumentimit për qarkullimin e aktiveve evidentohet pas daljes së urdhrit të titullarit. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296 dhe UMF nr. 30 institucioni duhet të dokumentonte këtë lëvizje për të garantuar sigurinë e aktiveve si dhe për të krijuar gjurmën e auditimit e cila përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin etj.

Është detyrë e Titullarit mbikëqyrja e zbatimit të urdhrave të nxjerrë dhe monitorimi i tyre. Ndërkohë që mungesa e gjurmës së auditimit ka bërë që të mungoj informacioni mbi periudhën e transferimit. Pajisjet e laboratorit sipas fletë-daljeve të magazines janë marrë në dorëzim prej ish Shefes së Sektorit LK, ndërkohë që me dorëzimin e detyrës nuk kemi një transferim të këtyre aktiveve. Përgjegjësia materiale duhet të parashikohej në aktet e brendshme rregullativ mbi mënyrën e lëvizjes dhe qarkullimit të aktiveve brenda njësisë e cila aktualisht mungon. Mënyra e ndjekur mbi përgjegjësinë materiale direkte me kartelën e inventarit është e pasaktë në mungesë të akteve rregullues. Mungesa e përgjegjësit material në disa kartela nuk qëndron derisa aktivi është gjendje. Sa i përket zgjatjes së procesit të inventarizimit titullarit legjislacioni ka parashikuar mekanizma mbi autorizimin, mbikëqyrjen dhe raportimin si dhe marrjen e masave përkatëse. Mbyllja e plotë e procesit të inventarizimit dhe pa diferenca materiale përbën zhvillim pozitiv por jo të mjaftueshëm.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë nga ana jonë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Titulli i Gjetjes nr.:	Procesi i inventarizimit dhe qarkullimit të aktiveve paraqitet me mangësi.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në muajin Nëntor 2018 kishte filluar procesin e transferimit të veprimtarisë së saj pranë Institutit të Shëndetit Publik si rrjedhojë e nisjes së rikonstruksionit dhe shtesës të objektit ku ushtrohej veprimtaria. Ky transferim i aktiveve është shoqëruar dhe ka evidentuar disa problematikat të cilat trajtohen si më poshtë. a. Institucioni nuk rezulton të ketë përmbushur detyrimin e tij për inventarizimin vjetor për periudhën ushtrimore viti 2018 si përpara transferimit ashtu dhe pas tij, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 74 dhe 75 i tij. Ndërkohë që procesi i inventarizimit për vitin ushtrimor 2019 kishte nisur në muajin Janar 2020 sipas Urdhrit të Titullarit nr. 4 dhe nr. 5 datë 08.01.2020, finalizimi i këtij procesi është realizuar në muajin Gusht 2020, kur institucioni është rikthyer pjesërisht në objektin e rikonstruktuar, pra pas rreth 7 muajsh përtej afatit të parashikuar fillimisht. Zvarritjet dhe zgjatjet në kohë të procesit të inventarizimit, cenojnë besueshmërinë e procesit si dhe krijojnë rrisk në mirëmenaxhimin e aktiveve të njësisë. b. Evidentohet se, transferimi i aktiveve në kuadër të ristrukturimit nga AKBPM te Instituti i Shëndetit Publik dhe anasjelltas, nuk është shoqëruar me dokumentacion të nevojshëm si, procesverbale, listë aktivesh të zhvendosura sipas datave, mjetet e transportit të përdorura, oraret e lëvizjes, personat shoqëruar, Fletë-ngarkesa, etj. Mungesa e tyre, pavarësisht faktit se në inventarizimin e fundit të kryer nga institucioni nuk rezultojnë diferenca materiale, ka krijuar mosdokumentim të procesit dhe mungesë të gjurmës së auditimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 pika 3 pika dh) dhe f) si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 34, 36, 51 e tij. Evidentohet se, hartimi i rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari lidhur me procedurat për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike është një hap i nevojshëm, për të përmirësuar cilësisht procesin në funksion të ruajtjes dhe dokumentimit të tyre, si dhe garantimit të efektivitetit të kontrolleve të brendshme të institucionit.
Kriteri:	-Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 pika ç) dhe ë), neni 12, neni 3 pika dh) dhe f) etj; -UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 5, 6, 34, 36, 51, 74 dhe 75 etj; -Rregullore e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AKBPM”, nr. 264 prot, datë 25.09.2017;
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë sa i përket marrjes në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen e aktiveve të njësisë publike.
Shkaku:	Mosmarrje e masave të nevojshme rregullative e procedurale.
Rëndësia:	E lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Drejtimi 2: “Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”

Mbi veprimtarinë e Sektorit të Laboratorit të Kontrollit

Në zbatim të kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- Rregullore e Brendshme miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 264 datë 25.09.2017;
- Struktura e Agjencisë miratuar me VKM nr. nr. 24 datë 14.01.2015, e ndryshuar;
- Bordero e pagave Tip muaji Gusht 2020;
- Auditimi i Departamentit të Performancës miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 34 datë 04.08.2019;
- Tabelë me tregues të analizave vjetore të kryera nga Laboratori i Kontrollit;
- Shkresa nr. 9292/14 prot, datë 16.09.2019;
- Shkresa nr. 7606/75 prot, datë 09.03.2020;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi:

Referuar strukturës së miratuar me VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar Sektori i Laboratorit të Kontrollit ka të parashikuar një staf prej 19 punonjësish nga të cilët,

- ✓ Shef Sektori 1
- ✓ Analist 14
- ✓ Laborant 4

Aktualisht sektori operon me një personel prej 18 (1+17) punonjësish .

Laboratori i Kontrollit siguron dhe përgjigjet për kontrollin cilësor të barnave brenda fushës së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën.

Në këtë kuadër ky sektor kryen analizat fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të formave të dozuar të barnave të importuara/të prodhuara në vend, të lëndëve të para farmaceutike, analizon mostrat që shoqërojnë dokumentacionin për dhënie autorizimi për tregtim, analizon barnat e ndryshme të marra në formë sondazhi, gjatë procesit të verifikimit fizik të barnave të importuara apo të prodhuara në vend, si dhe në çdo rast kur ka import të parë, apo gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese dhe mbikëqyrëse të barnave të vendosura në treg, lëshon certifikatën e analizës, etj.

Pra funksioni i këtij laboratorit është jetik për procesin e garantimit si të barnave të prodhuara në vend ashtu dhe atyre të importuara.

Mbi bazën e treguesve dhe të dhënave shkresore të vëna në dispozicion prej Sektorit të laboratorit të Kontrollit, në AKBPM, rezulton se, numri gjithsej i analizave të kryera për vitin 2019 është 68 të tilla dhe prej datës 14.10.2019 pra për rreth 11 muaj nga ky laborator nuk janë kryer më analiza barnash. Treguesit e analizave të kryera për periudhën vitet 2014 - 2020/09 situata paraqiten si më poshtë vijon:

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020/09
Nr. Analizash	498	195	236	129	169	68	0

Burimi: Sektori i Laboratorit të Kontrollit në AKBPM, përpunuar nga grupi i auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Grafiku nr. 1 Ecuria e analizave të kryera për e barnat sipas periudhës



Nëse i referohemi të dhënave analitike dhe grafike rezulton se, numri i analizave të kryera gjatë vitit 2019 i cili përkon edhe me procesin e transferimit të laboratorit paraqitet me një numër mjaft të vogël analizash gati 13.6% e analizave të kryera në vitin 2014 përpara daljes së VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar. Problematika lidhur me numrin e ulët të analizave të kryera është evidentuar edhe në auditimin e kryer nga Departamenti i Performancës në KLSH në AKBPM, por jo vetëm, me objekt “CILËSIA DHE SIGURIA E BARNAVE NË RRJETIN E HAPUR FARMACEUTIK DHE SHËRBIMIN SPITALOR”, evaduar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 34 datë 04.08.2019 ku trajtohet se, për periudhën 2017-2018 institucioni ka kryer vetëm 12% të barnave që duhej të analizonte. Në vijim të problematikave të trajtuara janë lënë dhe rekomandimet përkatëse, por pavarësisht tyre situata nuk paraqitet e përmirësuar por ka pësuar ulje deri në moskryerje të tyre. Prej muajit Tetor 2019 në të cilën është bërë analiza e fundit, institucioni për rreth 11 muaj nuk ka nxjerr asnjë analizë çka nuk ka mundur analizimin e barnave në treg me cilësi dhe efikase për popullatën.

Pavarësisht nevojës për përmirësimin e infrastrukturës, vijimi i punës në kryerjen e analizave mbetet qëllimi bazë, çka përmendet edhe në urdhrat e nxjerr nga Titullari i Institucionit përkatësisht Udhurat e Brendshëm nr. 297 datë 07.11.2018, “Për marrjen e masave dhe organizimin e punës për lirimin e ambienteve të institucionit” nr. 302 datë 12.11.2018 “Për zhvendosjen e vlerave dokumentare dhe materiale të institucionit” dhe nr. 307 datë 16.11.2018. Sipas shkresës nr. 7606/75 prot, datë 09.03.2020 hartuar prej Titullarit drejtuar Shefit të Sektorit “Mbi ecurinë e laboratorit” citon se, “...Në kushtet aktuale ku jemi, shkak i dukurive natyrore (tërmetet) që solli dëmtimin e ambienteve të laboratorit të ISHP-së ku jemi të vendosur aktualisht, laboratorit i Kontrollit do të vijojë me përgatitjen e dokumentacionit, metodologjia dhe procedurat që do të ndiqen për akreditimin e Laboratorit të Kontrollit..”.

Pra sa më sipër por edhe sa trajtuar në auditimin e cituar më lartë nga Departamenti i Performancës në KLSH, zhvendosja e laboratorit është bërë i pastudiuar pasi në mënyrë direkte zhvendosja do të pezullonte punën e specialistëve për një kohë të gjatë. Ngjarjet e jashtëzakonshme si tërmeti i 26 Nëntorit por edhe Pandemia COVID-19 shpallur në fund të muajit Mars 2020 kanë patur gjithashtu ndikimin e tyre negativ në këtë situatë, megjithatë mungesa e analizave në afatgjatë ka ndikime të rëndësishme në ruajtjen e shëndetit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

popullatës dhe ato nuk mund të justifikojnë ndërprerjen e plotë të analizave. Sektorit i Laboratorit të Kontrollit objektin kryesor të punës e ka të lidhur pikërisht me kryerjen e analizave të barnave. Analiza e fundit në këtë sektor, cituar dhe më sipër, regjistrohet në muajin Tetor 2019 dhe më pas institucioni nuk ka vijuar kryerjen e tyre dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është ndërprerë tërësisht. Në periudhën pas ndërprerjes së analizave punonjësit janë ngarkuar me detyra plotësuese mbi përgatitje materiale mbi procesin e akreditimit i cili pavarësisht vlerës së shtuar që sjell, nuk justifikon moskryerjen e analizave mbi barnat, që është objekti kryesor i punës së veprimtarisë së sektorit. Vlera e shpenzuar për 18 punonjës të kësaj njësie në fond page dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar 2019-Gusht 2020, në të cilin numri i analizave ka pësuar tkurrje deri ndërprerje të tyre, përbën shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e parimet e efektivitetit, efikasitetit, dhe ekonomicitetit të fondeve publike.

Tabela nr. 1: Shpenzimet e kryera për personelin e Sektorit të Laboratorit

Nr.	Emërtimi i Shpenzimit	Vlera
a.	Fondi mujor i pagave bruto	1,126,850
b.	Muaj Janar 2019-Gusht 2020	20
I	Fond page gjithsej (a x b)	22,537,000
II	Kontributet e sig. shoq dhe shënd. 16.7% e Fondit të pagës	3,763,679
III	Vlera e shpenzuar gjithsej I+II	26,300,679

Burimi, AKBPM përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më lartë, nuk evidentohet gjithashtu roli mbikëqyrës i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin e organit epror i cili referuar dispozitave të ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 22 “Përgjegjësia për mbikëqyrjen” pika 1 e tij, përcakton se;

1. Çdo ministër është përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së ministrisë, të institucioneve të varësisë dhe të agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore. Kryeministri është përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve të varësisë ose të agjencive autonome në varësi të tij.

Si dhe neni 23 “Mbikëqyrja e institucioneve të varësisë dhe e agjencive autonome” pika 1 e tij, përcakton se;

1. Institucionet e varësisë dhe agjencitë autonome mbikëqyrren për:

a) realizimin e objektivave të miratuar politikë dhe të menaxhimit;

b) ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimin financiar.

Po kështu MSHMS prej rreth 4 (katër) vitesh nuk evidentohet të ketë në funksion Njësine e Posaçme për kontrollin periodik të AKBPM dhe sa herë të shihet e nevojshme në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 184 datë 09.03.2016 çka paraqet nevojën imediate për rishikimin e qasjes institucionale në këtë fushë.

Gjithashtu MSHMS si organ emërtese nuk rezulton të ketë plotësuar strukturën e AKBPM me personel të plotë ku evidentohet edhe mungesa e dy pozicioneve kyçe përkatësisht Zv. Drejtorëve Teknik dhe atij Ekonomik të cilët janë pjesë e menaxhimit të institucionit.

Problematikat e trajtuara më sipër evdientojnë se AKBPM dhe MSHMS në organit epror nuk kanë arritur të garantojnë sigurinë dhe cilësinë e barnave në treg duke mospërmblusur detyrimet e tyre funksionale e ligjore. Fondet e pagave dhe kontributeve rezultojnë të jenë përdorur pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

-Znj. N. S me detyrë, Drejtori i AKBPM/NA.

Për mospërbushjen e detyrimit për kryerjen e analizave nga ana e sektorit në analizimin e barnave me ndikim në përdorimin e fondeve publike pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike, referuar kjo VKM nr. 24 datë 14.01.2015 “Për Miratimin e Strukturës dhe Mënyrës së Funksionimit e Organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”; i ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 pika 9, 16, 20, neni 8, neni 9 e vijues si dhe akteve nënligjore të dala për zbatim të tyre.

-Znj. M.K me detyrë, Shef i Sektorit të Laboratorit.

Për mospërbushjen e detyrimit për kryerjen e analizave nga ana e sektorit në analizimin e barnave me ndikim në përdorimin e fondeve publike pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet, referuar, Kontratës individuale të punës lidhur mes palëve, Rregullores së Brendshme të AKBPM miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 264 datë 25.09.2017, neni 10 i saj, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4 pika 9, 15, neni 11 e vijues.

Nga subjekti i audituar, znj. N.S, znj. F.Z dhe znj. M.R, është paraqitur observacioni lidhur me Projektraportin, i regjistruar në AKBPM me nr. 5950/11 prot, administruar në KLSH me nr.812/8, datë 22.12.2020, ku prej përfaqësuesve të subjektit janë shprehur objeksionet si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit:

4/5-Në lidhje me Gjetjen nr.1 të (faqe 27-28 të Projekt Raportit)të grupit të auditimit që ka të bëjë me “Moskryerjen e objektit primar të punës së Laboratorit të Kontrollit që është analiza e barnave, duke lënë pa punë funksionale 18 punonjës të kësaj njësi dhe duke ju ngarkuar detyra plotësuese mbi përgatitje materiale mbi procesin e akreditimit...” është një gjetje e pabazuar në fakte dhe prova.

-Raporti i Auditimit të Performanës me Nr.Prot. 1425/21 datë 04.08.2019 ku citohet se, “.....Pra akreditimi i laboratorit dhe mirëmbajtja e tij, në rastin tonë të laboratorit të barnave pranë AKBPM, ka rëndësi shumë të madhe, jo vetëm për barnat që hyjnë në tregun vendas por dhe ato që eksportohen...”

Rekomandimi se nga ana e AKBPM të merren masat e nevojshme për nisjen e punës, ...nuk është i bazuar në fakte konkrete, dhe për këtë arsye rekomandimi duhet ti adresohet Shefes së Laboratorit të Kontrollit znj. M.K si shkaktar i mosfunksionimit të sektorit që ajo drejton aktualisht.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Në lidhje me sa pretenduar sqarojmë se, tashmë është fakt që procesi i kryerjes së analizave mbi barnat e importuar dhe atyre për eksport ka munguar për rreth një vit. Kryerja e analizave është detyra kryesore e institucionit ndërkohë e përcaktuar kjo në VKM nr. 24, Rregulloren e Brendshme neni 3 pika 1, neni 10 e vijues i saj, etj. Procesi i akreditimit, është i rëndësishëm pasi pritët të sjelli përmirësim cilësor në kryerjen e analizave megjithatë institucioni duhet të merrte masat e nevojshme për vijimin e punës dhe jo ndërprerjen e tyre. Sa i përket përgjegjësisë në këtë rast ajo mbetet e drejtuesve përkatësisht Titullarit të Institucionit dhe Shefes së Laboratorit të Kontrollit, të cilat nuk kanë arritur të përmbushin me efikasitet funksionet e tyre menaxheriale.

Sa më sipër, observacioni nuk paraqet asnjë të dhënë apo argument shtesë të vlefshëm mbi çështjet e trajtuara në material e si i tillë ai nuk merret në konsideratë nga ana jonë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nga znj. N.S, regjistruar në AKBPM me nr. 5950/7 prot, administruar në KLSH me nr.812/3, datë 30.09.2020, ku janë shprehur objeksionet lidhur me Akt-Konstatimin nr. 2 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Rezulton se, në aspektin objektiv nga Grupi i Auditimit të KLSH-së është pranuar rregullsia e veprimeve të kryera dhe e rregullave të vendosura nga institucioni ..por situata “non sens” në mënyrën e parashikuar për miratimin e rregullave, ka sjellë mbivendosje, dublim apo keqinterpretim të detyrave...

Vlen të theksohet se ecuria e Laboratorit të Kontrollit sipas përcaktimit të bërë nga ana juaj nuk na rezulton objekt i veprimtarisë audituese. ...Në lidhje me konstatimin se: numri i analizave të kryera gjatë vitit 2019 ...paraqitet me një numër mjaft të vogël...nuk qëndron ..është një interpretim i kundërt me konstatimin e bërë nga vet audtuesit për procesin e transferimit (Për shkak force madhore)..

-nga stafi Laboratorit të Kontrollit është vijuar me përgatitjen e dokumentacionit...

-nuk ekzistonte asnjë mundësi fizike për të kryer këtë proces pune..

Titullari i Institucionit i ka marrë të gjitha masat për organizimin e punës për lirimin dhe zhvendosjen...konkretisht me Urdhrin e Brendshëm nr. 297 datë 07.11.2018 ...nr.302 datë 12.11.2018...Rezulton i provuar urdhërimi i Titullarit të Institucionit për vijimin e veprimtarisë së Laboratorit dhe përgatitjen e anës dokumentare të procesit të Akreditimit..

Prokurimi.. ishte në process prej fillim vitit 2018...për me tepër studimi për zhvendosjen e personelit dhe lirimin e ambienteve të Agjencisë nuk ishte bërë nga Titullari aktual i Agjencisë, i emëruar datë 26.09.2018...

Ngjarjet e jashtëzakonshme si tërmetii 26 Nëntorit dhe pandemia Covid-19 ...provon të kundërtën të asaj çka konstato Grupi i Auditimit për shkaqet e zhvendosjes....të cilat nuk mund ti ngarkohen institucionit...Stafi i Laboratorit të Kontrollit ka dhe detyra të tjera ligjore-administrative ...Për rrjedhojë dhe konstatimi se: “Vlera e shpenzuar prej institucionitpërbën shpenzim jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficencës..nuk qëndron...

..ende sot nuk ka një strategji të qartë nga Shefi i Laboratorit të Kontrollit ..mbi procedurat që do të ndiqen për Akreditimin...rezultati si më sipër është lehtësisht i matshëm dhe I veirifikueshëm...në lidhje me konstatimin se nuk evidentohet mbikëqyrja e Ministrisë... ky pretendim nuk qëndron pasi me anë të raportimeve periodike , ose rast pas rasti në varësi të problematikave, provohet marrëdhënia e bashkëpunimit me Organin epror...Për më tepër, nuk rezulton asnjë fakt i provuar me dokumentacion mbi veprimtarinë e Shefes së Laboratorit (znj. M.K), gjë e cila provon moskryerjen e detyrave nga ana e saj me veprime apo mosveprime..

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Mangësitë e akteve mbi të cilat bazohet veprimtaria e AKBPM, është trajtuar më hollësisht gjatë trajtimit të pjesës “mbi rregulloren e brendshme”. Ndërkohë trajtimi mbi veprimtarinë e Laboratorit i referohet pikës nr. 2 të programit të auditimit “Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”. Lidhur me masat e marra vlen të theksojmë se, procesi mbi rikonstrukcionin kishte filluar përpara se ju si titullar të emëroheshit ndërkohë që lirimi i ambienteve dhe përgjatë gjithë periudhës në vijim veprimtaria e LK ka vijuar nën drejtimin Tuaj. Ngjarjet madhore janë pranuar me ndikimin e tyre në veprimtarinë por ajo që vërehet nuk është ulja e numrit të analizave por mosfunksionimi i plotë i kryerjes së tyre çka në vlerësimin tonë nuk gjendet e justifikuar. Nga ana jonë nuk vihet në diskutim fakti që punonjësit nuk kanë qenë në marrëdhënie pune por mospërmbushja e detyrave sektoriale bazë mbi kryerjen e analizave të barnave duke sjellë që veç të tjerash përdorimin pa efektivitet dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

efiçencë të fondeve. Problematikat e brendshme Titullar-Shef Sektori janë evidente por pavarësisht dërgimit nga ana juaj të informacioneve drejt MSHMS mbi këtë konflikt baza ligjore aktuale ju ka lënë juve si Titullar menaxhimin dhe zgjidhjen e probematikave, çka evidentohet dhe në përgjigjet e minisitrisë përgjegjëse. Lidhur me procesin e mbikëqyrjes nga MSHMS dhe problematikave të hasura qëndrimi ynë mbetet i njëjtë, pra evidentohet mospërbushje dhe mangësi të theksuara prej tij si organ epror drejt institucionit të varësisë. Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë nga ana jonë.

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.812/2, datë 28.09.2020 nga znj. M.K, ku janë shprehur objeksionet lidhur me Akt-Konstatimin nr. 2 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

...Laboratori për vet specifikën, ndryshe nga çdo sektor tjetër të cilit minimalisht i duhet një kompjuter, tavolinë dhe një dollap dhe në këtë rast gjen gjen zbatim U.B për moscënim i vijueshmërisë së punës. Laboratori pa aparatura, pajisje, reagente dhe ambiente me kushte aspirimi pasi reagentët janë me fekte të dëmshme për shëndetin e stafit të laboratorit dhe mjedisit, nuk mund të funksionojë, pra ndryshe nga sektorët e tjerë siuate e laboratorit është mjaft specifike dhe është e pamundur të mos cënohet vijueshmëria e punës.... Në muajin Gusht 2019 kur u mundësua përdorimi i aparaturave për analizimin e mostrave nr. i analizave ishte 17 mostra, pra nuk është paaftësi e shefit të Laboratorit por mungesë e kushteve për përmbushjen e detyrave funksionale...

Analizat do të kryeshin një ditë në javë në aparaturën e ISUV...e cila hasi në shumë vështirësi në zbatimin e saj dhe për këtë kam bërë me dije në cdo hap drejtorin e AKBPM-së... Nga ana ime si Shef Sektori janë bërë të gjitha përpjekjet për kryerjen e analizave të mostrave duke respektuar rregullat dhe ligjet...

-Në lidhje me sa trajtoni se “Fondet e pagave dhe kontributeve janë përdorur pa efikasitet dhe efektivitet” duke mosqenë specialist e fushës së financës, por në detyrën e Shefes së Laboratorit do të shprehja mendimin tim se personeli i laboratorit nuk paguhet me normë, pra nuk është e varur nga sasia e analizave që ai kryen... Do të ishte përgjegjësia ime si Shefe Laboratori nëse stafi i laboratorit ishte paguar, në rastet kur ai nuk është paraqitur në punë dhe unë e kam raportuar në listëprezencë sikur kishte ardhur në punë apo unë të kem lejuar shpërdorime dhe keqpërdorime nga ana e stafit...

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nisur nga argumentat e paraqitura prej jush sqarojmë se, Laboratori i Kontrollit nuk ka funksionuar rrjedhojë e mosmenaxhimit të duhur të situatës nga drejtuesit, titullari i institucionit dhe shefi i sektorit. Problematika i ka fillimet në përgatitjet përpara transferimit si dhe periudhës në transferim ndaj vlerësimi mbi procesin nuk mund të merret i shkëputur në periudha të veçanta. Urdhrat e Titullarit dhe detyrat konkrete të sektorit, përcaktojnë qartë përgjegjësitë mbi ecurinë dhe vijueshmërinë e punës në laborator. Për aq kohë sa kjo veprimtari është cënuar përgjegjësia në mënyrë direkte bie mbi menaxhimin.

Lidhur me mungesën e efektivitetit dhe efiçencës në shpenzimet për paga e sigurime të shpenzuara për Sektorin e Laboratorit qëndrimi ynë mbështetet në mungesën e veprimtarisë bazë nga ky sektor në kryerjen e analizave, çka bën që fondet e shpenzuara të jenë kryer në mospërputhje me këto parime.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë nga ana jonë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

- Kuadri ligjor dhe rregullativ i Institucionit

Në zbatim të kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- Rregullore e Brendshme miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 264 datë 25.09.2017;
- Dokumenti “Përshkrimet e punës”, i përcjell në MSHMS;
- Praktikat të shqyrtuara;
- Të tjera akte, ligjore, nënligjore, administrative etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi:

Rregullorja “Mbi mënyrën dhe procedurat e punësimit, lëvizjet, dhe transferimet e personelit në AKBPM” është miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë me urdhrin nr. 201 datë 30.04.2015.

Rregullorja e Brendshme është miratuar me Urdhrin e Titullarit nr. 264 datë 25.09.2017.

Dokumenti Përshkrimet e punës e cila sipas VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar duhet të propozohen nga Drejtori i AKBPM dhe të miratohen nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë megjithëse janë përcjell zyrtarisht pranë ish-Ministrit të Shëndetësisë me shkresën nr. 3212 prot, datë 08.05.2017 ende nuk ka një miratim zyrtar të tyre apo shkresë për rregullim apo plotësim të tyre. Pra efektivisht AKBPM nuk zotëron ende përshkrime pune mbi proceset dhe detyrat, çka në mënyrë direkte cënon ndarjen dhe përcaktimin e qartë të detyrave individuale në veprimtarinë e institucionit.

Kontradiktor mbetet fakti që në përcaktimet e VKM të sipërcituar, “Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Agjencisë” mbi të cilën mbështetet puna e Agjencisë hartohet dhe miratohet nga Drejtuesi i Institucionit ndërsa Përshkrimet e Punës të cilat janë derivat i kësaj rregullore miratohen nga organi epror. Kjo përbën një situatë “*non sens*” për atë kohë sa detyrat bazë përcaktohen nga Titullari dhe proceset përcaktohen nga Ministria, ndërkohë që situata duhet të ishte e kundërt. Në Rregulloren e Brendshme përcaktohen jo vetëm detyrat por gjithë veprimtaria e institucionit përfshirë edhe dhënia e masave disiplinore. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “*konflikt interesi*” i cili ka ndikuar ose mund të ketë ndikuar në paanshmërinë dhe objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm.

Miratimi i rregullores duhet të bazohet në dispozitat e ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” ku pika 2 e tij, përcakton se;

2. Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.

Kjo rregullore mund të vlerësohet edhe si një dokument komplementar i cili të integroj detyrat funksionale dhe ato individuale. Hartimi dhe miratimi nga organi epror i një dokumenti të vetëm do të eliminonte “*konfliktin e interesit*”, dublimin e dokumentacionit si dhe mbivendosjen dhe keqinterpretimin e detyrave.

Nga subjekti i audituar, znj. N.S, znj. F.Z dhe znj. M.R, është paraqitur observacioni i regjistruar në AKBPM me nr. 5950/11 prot, administruar në KLSH me nr.812/8, datë 22.12.2020, ku prej përfaqësuesve të subjektit janë shprehur objeksionet lidhur me Projektraportin, si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

Pretendimi i subjektit:

6-Gjetja 1 që ka të bëjë me bazën ligjore dhe rregullative të institucionit fq 21 dhe 24 e Projekt-raportit ku citohet se: “Pra ende AKBPM nuk zotëron përshkrime mbi proceset e punës.... ” nuk qëndron në lidhje me arsyetimin e grupit të Auditimit. Sa më sipër rezulton e provuar me: a)Praktikën e plotës shkresore me Nr.3732Prot. datë 25.04.2018 “Mbi përshkrimin e punës dhe metodikat e punës në laborator” të Shefit të Laboratorit të Kontrollit...”. b)Akt –shkresor me Nr. 8387/2 prot. datë 24.10.2018 “Kthim përgjigje për shkresën 8387/1 datë 18.10.2018” e Shefit të Laboratorit të Kontrollit në lidhje me “Rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së Laboratorit të Kontrollit”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Në lidhje me sa pretendohet sqarojmë se, njëloj sa trajtuar edhe më parë, referuar VKM nr. 24 institucioni duhet të dispononte dy dokumentat bazë të cilat rregullojnë veprimtarinë institucionale, a) Rregulloren e Brendshme e cila miratohet nga Titullari dhe b) Dokumentin “Përshkrimet e Punës” e cila propozohet nga institucioni dhe miratohet nga Ministri përgjegjës. Dokumenti i dytë nuk rezulton ende i miratuar e megjithatë nga ana juaj paraqiten njëvlerësim i tij disa propozime për Draft-Rregullore të muajit prill 2018 çka nuk gjendet korrekte referuar akteve të parashikuara. Megjithatë nga ana e grupit të auditimit mënyra e miratimit të hartimit dhe miratimit të këtyre akteve nuk është gjetur në përputhje me përcaktimet ligjore bazë mbi të cilat rregullohet veprimtaria administrative shtetërore dhe për këtë janë propozuar ndryshimet përkatëse.

Sa më sipër, observacioni nuk paraqet asnjë të dhënë apo argument shtesë të vlefshëm mbi çështjet e trajtuara në material e si i tillë ai nuk merret në konsideratë nga ana jonë.

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nga znj. N.S dhe znj. M.R, regjistruar në AKBPM me nr. 5950/8 prot, administruar në KLSH me nr.812/3, datë 30.09.2020, ku janë shprehur objeksionet lidhur me Akt-Konstatimin nr. 3 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Nuk mund të gjykohet një veprim ose mosveprim “rregull sjellje” në institucion, i cili nuk parashikohet apo rregullohet shprehimisht në ligj...

Rezulton se, në aspektin objektiv nga Grupi i Auditimit të KLSH-së është pranuar rregullsia e veprimeve të kryera dhe e rregullave të vendosura nga institucioni ..por situata “non sens” në mënyrën e parashikuar për miratimin e rregullave, ka sjellë mbivendosje, dublim apo keqinterpretim të detyrave.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Agjencia rezulton të ketë zbatuar detyrimin e parashikuar në VKM mbi miratimin e rregullores së brendshme si dhe dërgimin për miratim në ministrinë përgjegjëse të përshkrimeve të punës. Në mungesë të një miratimi të shprehur, institucioni mund të kishte ndërmarrë iniciativa mbi ecurinë e këtij procesi duke rikërkuar miratimin e tyre. Megjithatë në këtë rast mangësia i përket organit epror i cili duhet të garantonte një sistem rregullash në përputhje me parimet parashikuara në ligjin nr. 90/2012.

Për sa më sipër observacioni merret në konsideratë nga ana jonë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

• Shkresa e paraqitur në KLSH me nr. 868 prot, datë 11.09.2020

Grupi i auditimit nisur nga pretendimet e ngritura në shkresën e sipërcituar, auditori mbi bazë përzgjedhje rastësore një grup praktikash lidhur me përputhshmërinë procedurale mbi pranimin, trajtimin dhe përgjigjet e kthjera nga institucioni sa i përket aplikimeve për miratim të autorizim tregëtimi.

Baza ligjore e përdorur për procedurat e ndjekura:

-Ligji nr. 105/2014 datë 31.07.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar;

-Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 08.04.2015 “Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4 pika 2, gërma a) dhe b) e tij.

Nga auditimi i disa praktikave të zgjedhura në mënyrë rastësore sa i përket procedurës nga ana e institucionit rezultoi se,

-“Bari D..., tabletë x 1mg”, me mbajtës të Autorizimit për Tregtim N.....s.a., Greqi, aplikuar pranë AKBPM me kërkesën nr. 24/9 prot, datë 06.03.2020, nga kompania M.... sh.p.k. Kthim përgjigje e institucionit është bërë me shkresën nr. 24/12 prot, datë 06.04.2020. Nga kjo datë bari është në procedurë regjistrimi ku dokumentacioni përkatës po shqyrtohet brenda afateve të parashikuara në VKM.

-“Bari D....tablete x 2.5mg”, me mbajtës të Autorizimit për tregtim N.....a., Greqi, aplikuar pranë AKBPM me kërkesën nr. 24/7 prot, datë 06.03.2020, nga kompania M..... sh.p.k. Kthim përgjigje e institucionit është bërë me shkresën nr. 24/13 prot, datë 06.04.2020. Nga data 06.03.2020 bari është futur ne procedurë regjistrimi ku dokumentacioni përkatës po shqyrtohet brenda afateve të parashikuara në VKM.

-“Bari V..... tabletë e veshur me film x 5mg/160mg/12.5mg”, me mbajtës të Autorizimit për Tregtim K.....d., N..., Slloveni, aplikuar prane AKBPM me kërkesë me nr. 72/7 prot, date 05.03.2020, nga kompania përfaqësuese K....., Shqipëri. Kthim përgjigje e institucionit është bërë me shkresën nr. 72/12 prot, datë 03.04.2020. Nga data 05.03.2020 bari është futur në procedurë regjistrimi ku dokumentacioni përkatës po shqyrtohet brenda afateve te parashikuara ne VKM.

-“B.....tabletë e veshur me film x 10mg” me mbajtës të Autorizimit për Tregtim P..... SA, Portugali, aplikuar pranë AKBPM me kërkesën nr. 2585 prot, datë 14.04.2020, nga kompania M..... sh.p.k., Shqipëri. Refuzimi e institucionit është bërë me shkresën nr. 2585/4 prot, datë 13.05.2020, në të cilën është specifikuar arsyeja e refuzimit te aplikimit sipas nenit 4, pika 2. Dokumentacioni i është kthyer kompanisë që ka bërë aplikimin.

-“Bari B..... tabletë e veshur me film e kontrolluar x 50mg”, me mbajtës të Autorizimit per Tregtim I.....a.s., Turqi, aplikuar pranë AKBPM me Kërkese me nr. 703 prot, datë 06.02.2020, nga kompania F..... sh.a. Refuzimi i institucionit është bërë me shkresën nr. 703/6 prot, datë 04.03.2020, në të cilën është specifikuar arsyeja e refuzimit të aplikimit sipas nenit 4, pika 2. Dokumentacioni i është kthyer mbrapsht kompanisë që ka bërë aplikimin.

-“Bari L..., tabletë e veshur me film x 10mg/5mg”, me mbajtës të Autorizimit për Tregtim shoqërinë B.....s., Turqi, aplikuar pranë AKBPM me kërkesën nr. 22 prot, datë 03.01.2019, nga kompania përfaqësuese B....., Shqipëri. kthim përgjigje e institucionit është bërë me shkresë nr. 22/3 prot, datë 01.02.2019, pra brenda afatit kohor të përcaktuar në VKM. Nga data 03.01.2019 bari është futur në procedurë regjistrimi dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës brenda afateve te parashikuara ne VKM, konform nenit 5 pika 2. Mbajtësit të Autorizimit për Tregtim i janë bërë vërejtjet me shkrim ku është specifikuar se çfarë dokumentacioni duhet të plotësoj kjo sipas shkresës nr. 22/4 prot, datë 23.07.2019. Agjencia në vijim ka bërë ndërprejen e procedurës për këtë bar me shkresën nr. 22/5 prot, datë 23.09.2019, pasi kompania nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e vërejtjeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

-“B....., tabletë e veshur me film x 160mg + 12.5mg”, me mbajtës të Autorizimit për Tregtim T..... sh.p.k., Kosovë, aplikuar pranë AKBPM me kërkesën, nr. 3474 prot, datë 16.05.2019, nga kompania përfaqësuese T..... sh.p.k, Shqipëri. Kthim përgjigje e institucionit, shkresa nr. 3474/3 prot, datë 17.06.2020. Bari është futur në procedurë regjistrimi dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës brenda afateve të parashikuara në VKM mbajtesit të Autorizimit për Tregtim i janë bërë vërejtjet me shkrim nga institucioni ku janë specifikuar dokumentacionet duhej të plotësohen, kjo sipas shkresës nr. 3474/4 prot, datë 25.11.2019. Agjencia në vijim me shkresën nr. 3474/5 prot, datë. 27.01.2020, ka bërë ndërprerjen e procedurës për këtë bar pasi kompania nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e vërejtjeve.

-U auditua ecuria e regjistrimeve në protokollin e institucionit të praktikave të mësipërme si edhe praktikës së audituar mbi inventarin për aktivet prej nga rezultoi se, ato janë të regjistruara konform numrit fillestar të çeljes së praktikës.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Baza ligjore e rregullative e institucionit evidenton nevojën për rishikim dhe plotësim të mëtejshëm të saj.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, baza rregullative mbi të cilën bazohet veprimtaria e institucionit paraqet mangësi. Sipas bazës ligjore aktuale, konkretisht VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar, ka përcaktuar që kompetencën për miratimin Rregullores së Brendshme e ka Titullarit i institucionit i cili me Urdhrin nr. 264 datë 25.09.2017 e ka miratuar atë, ndërkohë sipas VKM-së së mësipërme dokumenti “Përshkrimet e Punës” duhet të propozohet nga Drejtori i AKBPM dhe të miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Përshkrimet e punës janë përcjellë zyrtarisht pranë ministrit përgjegjës me shkresën nr. 3212 prot, datë 08.05.2017 por ende nuk ka një miratim zyrtar apo shkresë për rregullim apo plotësim të tyre nga kjo e fundit. Pra aktualisht AKBPM nuk zotëron një ndarje të detajuar të punës, çka ndikon dhe në ndarjen e qartë të përgjegjësiave individuale për institucionin në tërësi. Kontradiktor paraqitet situata ku sipas VKM-së nr. 24, përcaktohet se, “Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Agjencisë” pra detyrat bazë mbi të cilën mbështetet puna e Agjencisë, hartohet dhe miratohet nga Drejtuesi i Institucionit ndërsa Përshkrimet e Punës të cilat në thelb janë derivat i kësaj rregullore dhe rregullojnë proceset e punës miratohen prej organit epror, ndërkohë që duhet të ishte krejt e kundërta. Në rregulloren aktuale, Titullari i institucionit përcakton jo vetëm detyrat por gjithë veprimtarinë e funksionale përfshirë masat disiplinore të punonjësve, llojet dhe procedurat për dhënien e tyre. Përcaktimi, hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “konflikt interesi” i cili mund të ndikoj në paanshmërinë dhe objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.
Kriteri:	-Ligji nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” ku pika 2 e tij.; -Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” -VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar,
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë institucionale.
Shkaku:	Mangësi në bazën ligjore e rregullative mbi të cilat bazohet veprimtaria institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Titulli i Gjetjes nr. 2:	Numri i analizave të kryera nga Agjencia ka rënie të vazhdueshme ndërkohë që për vitin 2020 ato mungojnë tërësisht.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, AKBPM është institucion përgjegjës, i cili ka për kompetencë kontrollin cilësor të barnave për të garantuar vendosjen në treg e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

	barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. Njësia përgjegjëse në AKBPM për kryerjen e analizave mbi barnat është “Sektori i Laboratorit të Kontrollit”. Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një tkurrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014. Pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019 por më pas institucioni nuk ka vijuar kryerjen e tyre dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është ndërprerë tërësisht. Në vijim punonjësit janë ngarkuar me detyra plotësuese mbi përgatitje materiale mbi procesin e akreditimit i cili pavarësisht vlerës së shtuar që sjell, nuk justifikon moskryerjen e analizave mbi barnat, që është objekti kryesor i punës së veprimtarisë së sektorit. Vlera e shpenzuar nga institucioni për 18 punonjësit pjesë e “Sektorit të Laboratorit të Kontrollit”, në fond page dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në mungesë të përmbushjes së detyrës kryesore të punës së këtij sektori në analizimin e barnave, përbën shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efikasitetit, dhe ekonomicitetit të fondeve publike.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; -Ligji nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar; -Ligji nr. 89/2014, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, të ndryshuar”, i ndryshuar; -VKM nr. 24 datë 14.01.2015 “Për Miratimin e Strukturës dhe Mënyrës së Funksionimit e Organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”; i ndryshuar; -Rregullore e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AKBPM”, nr. 264 prot, datë 25.09.2017;
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në përmbushjen e veprimtarisë institucionale me ndikime financiare negative në shumën rreth 26.3 milion lekë.
Shkaku:	Mosmarrje e masave të nevojshme përpara dhe gjatë transferimit të institucionit.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 3:	MSHMS nuk rezulton të ketë përmbushur rolin e organit epror dhe nuk ka ngritur ende strukturën e posaçme kontrolluese parashikuar nga VKM nr. 184.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, në problematikat e evidentuara në AKBPM mbi mungesën e “Përshkrimeve të Punës” të miratuara, stafit të lartë drejtues, mangësitë mbi menaxhimin e aktiveve, ndërprerjen e kryerjes së analizave mbi barnat, nuk evidentohet roli mbikëqyrës i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si organi epror, referuar kjo dispozitave të ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 22 pika 1, si dhe neni 23 pika 1 e tij. Konstatohet gjithashtu se, megjithëse Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 184 datë 09.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e kontrollit për veprimtarinë e agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore, në zbatimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë nga kjo agjenci”, ka miratuar krijimin e “Njesisë së Posaçme” për kontrollin periodik dhe sa herë të shihet e nevojshme të AKBPM, prej më tepër se 4 (katër) vitesh nga miratimi i këtij vendimi, MSHMS nuk rezulton ta ketë bërë efektive duke ushtruar kontrolle me këtë strukturë, në kundërshtim me parashikimet në këtë vendim.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

	Sa më lartë, situata paraqet nevojën imediate për përmbushjen e rolit të MSHMS si organ epror në mirëfunksionimin institucioneve, realizimin e objektivave të miratuar, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimin financiar, çka nuk përkon në rastin konkret.
Kriteri:	-Ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 22 pika 1, si dhe neni 23 pika 1 e tij; -VKM nr. 184 datë 09.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e kontrollit për veprimtarinë e agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore, në zbatimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë nga kjo agjenci” -VKM nr. 24 datë 14.01.2015 “Për Miratimin e Strukturës dhe Mënyrës së Funksionimit të Organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”; i ndryshuar;
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në përmbushjen e veprimtarisë institucionale.
Shkaku:	Mungesë e mbikëqyrjes institucionale, bashkëveprimi, zbatimit të akteve ligjore.
Rëndësia:	E lartë

IV- GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si *më poshtë*:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, baza rregullative mbi të cilën bazohet veprimtaria e institucionit paraqet mangësi. Sipas bazës ligjore aktuale, konkretisht VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar, ka përcaktuar që kompetencën për miratimin Rregullores së Brendshme e ka Titullarit i institucionit i cili me Urdhrin nr. 264 datë 25.09.2017 e ka miratuar atë, ndërkohë sipas VKM-së së mësipërme dokumenti “Përshkrimet e Punës” duhet të propozohet nga Drejtori i AKBPM dhe të miratohej nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Përshkrimet e punës janë përcjellë zyrtarisht pranë ministrisë përgjegjëse me shkresën nr. 3212 prot, datë 08.05.2017 por ende nuk ka një miratim zyrtar apo shkresë për rregullim apo plotësim të tyre nga kjo e fundit. Pra aktualisht AKBPM nuk disponon një ndarje të detajuar të punës, çka ndikon dhe në ndarjen e qartë të përgjegjësisë individuale për institucionin në tërësi. Kontradiktore paraqitet situata ku sipas VKM-së nr. 24, përcaktohet se, “Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Agjencisë” pra detyrat bazë mbi të cilën mbështetet puna e Agjencisë, hartohet dhe miratohet nga Drejtuesi i Institucionit ndërsa Përshkrimet e Punës të cilat në thelb janë derivat i kësaj rregullore dhe rregullojnë proceset e punës miratohen prej organit epror, ndërkohë që duhet të ishte krejt e kundërta.

Në rregulloren aktuale, Titullari i institucionit përcakton jo vetëm detyrat por gjithë veprimtarinë e funksionale përfshirë masat disiplinore të punonjësve, llojet dhe procedurat për dhënien e tyre. Përcaktimi, hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “konflikt interesi” i cili mund të ndikoj në paanshmërinë dhe objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm. Miratimi i rregullave të brendshme të veprimtarisë duhet të bazohet rregullisht në dispozitat e ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, referuar VKM nr. 24, datë 14.01.2015, pika 3 gërma dh) e tij, ti kërkohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për propozimin e ndryshimeve të nevojshme në këtë vendim, për miratimin nga organi epror të të gjithë rregullave të brendshme të funksionimit dhe sjelljes, konform përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012.

Menjëherë

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në muajin Nëntor 2018 kishte filluar procesin e transferimit të veprimtarisë së saj pranë Institutit të Shëndetit Publik si rrjedhojë e nisjes së rikonstruksionit dhe shtesës të objektit ku ushtrohej veprimtaria. Ky transferim i aktiveve është shoqëruar dhe ka evidentuar disa problematikat të cilat trajtohen si më poshtë.

a. Institucioni nuk rezulton të ketë përmbyllur detyrimin e tij për inventarizimin vjetor për periudhën ushtrimore viti 2018 si përpara transferimit ashtu dhe pas tij, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 74 dhe 75 i tij. Ndërkohë që procesi i inventarizimit për vitin ushtrimor 2019 kishte nisur në muajin Janar 2020 sipas Urdhrit të Titullarit nr. 4 dhe nr. 5 datë 08.01.2020, finalizimi i këtij procesi është realizuar në muajin Gusht 2020, kur institucioni është rikthyer pjesërisht në objektin e rikonstruktuar, pra pas rreth 7 muajsh përtej afatit të parashikuar fillimisht. Zvarritjet dhe zgjatjet në kohë të procesit të inventarizimit, cenojnë besueshmërinë e procesit si dhe krijojnë rrisk në mirëmenaxhimin e aktiveve të njësisë.

b. Evidentohet se, transferimi i aktiveve në kuadër të ristrukturimit nga AKBPM te Instituti i Shëndetit Publik dhe anasjelltas, nuk është shoqëruar me dokumentacion të nevojshëm si, procesverbale, listë aktivesh të zhvendosura sipas datave, mjetet e transportit të përdorura, oraret e lëvizjes, personat shoqëruar, Fletë-ngarkesa, etj. Mungesa e tyre, pavarësisht faktit se në inventarizimin e fundit të kryer nga institucioni nuk rezultojnë diferenca materiale, ka krijuar mosdokumentim të procesit dhe mungesë të gjurmës së auditimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 pika 3 pika dh) dhe f) si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 34, 36, 51 e tij.

Evidentohet se, hartimi i rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari lidhur me procedurat për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike është një hap i domosdoshëm, i cili nevojitet për të përmirësuar cilësisht procesin në funksion të ruajtjes dhe dokumentimit të tyre, si dhe garantimit të efektivitetit të kontrolleve të brendshme. Kjo referuar ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 pika ç) dhe ë), si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 5,6 e vijues të tij. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 12-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, të merren masat e nevojshme për kryerje të paktën një herë vit të procedurave të plota të inventarizimit si dhe për grupe të veçanta aktivesh të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

kryhen inventarizime më të shpeshta me qëllim verifikimin e saktësisë së veprimeve të kryera nga njësia dhe eliminimin e abuzimeve apo keqpërdorimeve të mundshme.

Në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Titullari i AKBPM, të hartoj rregullore të veçantë në të cilën të evidentohen qartë procedurat, për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, për të siguruar mirëmenaxhimin e aktiveve dhe eliminuar keqkuptimet mbi përgjegjësinë materiale.

Brenda datës 31.03.2021

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, AKBPM është institucion përgjegjës, për kontrollin dhe analizimin e barnave, për të garantuar vendosjen në treg të barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. Njësia përgjegjëse në AKBPM për kryerjen e analizave mbi barnat është “Sektori i Laboratorit të Kontrollit”. Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një turrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014. Pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019. Pas kësaj periudhe institucioni nuk ka kryer më analiza dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është paralizuar tërësisht. KLSH në auditimin e kryer nga Departamenti i Performancës në KLSH në AKBPM gjatë vitit 2019, me objekt “Cilësia dhe Siguria e Barnave në Rrjetin e Hapur Farmaceutik dhe Shërbimin Spitalor” veç aspekteve të tjera ka evidentuar gjithashtu problematikën mbi numrin e ulët të analizave të kryera nga institucioni, ndërkohë që kryerja e tyre në vijim ka stopuar. Për periudhën vitet 2019 dhe në vijim institucioni ka ushtruar veprimtarinë në ambientet pranë Institutit të Shëndetit Publik si rrjedhojë e procesit të rikonstruksionit të godinës së vet. Më tej ngjarjet e jashtëzakonshme si tërmeti i 26 Nëntorit dhe Pandemia COVID-19 shpallur në fund të muajit Mars 2020 kanë patur gjithashtu ndikimin e tyre negativ në situatën mbi ambientet dhe veprimtarinë e stafit. Megjithatë, mungesa e analizave në afatgjatë ka ndikime të rëndësishme në ruajtjen e shëndetit të popullatës dhe për këtë institucioni përpara procesit të zhvendosjes dhe në vijimësi duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në garantimin e vijueshmërisë së punës së laboratorit dhe përmbushjen e detyrimit institucional mbi analizimin e barnave. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, të merren masat e nevojshme për rinisjen e punës së laboratorit të kontrollit, për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën dhe përmbushjen e detyrës funksionale të institucionit.

Menjëherë

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në problematikën e evidentuara në AKBPM mbi mungesën e “Përshkrimeve të Punës” të miratuara, stafit të lartë drejtues, mangësitë mbi menaxhimin e aktiveve, ndërprerjen e kryerjes së analizave mbi barnat, nuk evidentohet roli mbikëqyrës i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si organi epror, referuar kjo dispozitave të ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 22 pika 1, si dhe neni 23 pika 1 e tij. Konstatohet gjithashtu se, megjithëse Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 184 datë 09.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e kontrollit për veprimtarinë e agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore, në zbatimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë nga kjo agjenci”, ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

miratuar krijimin e “Njësisë së Posaçme” për kontrollin periodik dhe sa herë të shihet e nevojshme të AKBPM, prej më tepër se 4 (katër) vitesh nga miratimi i këtij vendimi, MSHMS nuk rezulton ta ketë bërë efektive duke ushtruar kontrole me këtë strukturë, në kundërshtim me parashikimet në këtë vendim.

Sa më lartë, situata paraqet nevojën imediate për përmbushjen e rolit të MSHMS si organ epror në mirëfunksionimin institucioneve, realizimin e objektivave të miratuar, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimit financiar. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masat e nevojshme për të bërë funksionale këtë strukturë dhe për të përmbushur kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Brenda datës 31.03.2021

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masat e nevojshme për plotësimin e organikës së AKBPM me personelin e nevojshëm konform strukturës së miratuar dhe bazës ligjore përkatëse.

Brenda datës 31.03.2021

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFİÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, AKBPM është institucion përgjegjës, i cili ka për kompetencë kontrollin cilësor të barnave për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. Njësia përgjegjëse në AKBPM për kryerjen e analizave mbi barnat është “Sektori i Laboratorit të Kontrollit”. Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një tkurrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014, pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019 por më pas institucioni nuk ka vijuar kryerjen e tyre dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është ndërprerë tërësisht. Në vijim, punonjësit janë ngarkuar me detyra plotësuese mbi përgatitje materiale mbi procesin e akreditimit i cili pavarësisht vlerës së shtuar që sjell, nuk justifikon moskryerjen e analizave mbi barnat, që është objekti kryesor i punës së veprimtarisë së sektorit. Vlera e shpenzuar nga institucioni për 18 punonjësit pjesë e “Sektorit të Laboratorit të Kontrollit”, në fond page dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën Janar 2019-Gusht 2020 llogaritet në vlerën rreth **26.3 milion lekë**, e cila në mungesë të përmbushjes së detyrës kryesore të punës së këtij sektori në analizimin e barnave, përbën shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiency, dhe ekonomicitetit të fondeve publike. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, pavarësisht procesit të akreditimit, të merren masat e nevojshme për rinisjen e punës së laboratorit për të garantuar vendosjen në treg e barnave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE”

sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën duke garantuar gjithashtu përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar nenet 37, e vijues , VKM nr. 24 datë 14.01.2015 “Për Miratimin e Strukturës dhe Mënyrës së Funkcionimit e Organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” i ndryshuar, ***i rekomandohet*** Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që nëpërmjet strukturave përkatëse, të analizoj dhe vlerësoj të metat, mangësitë si dhe përgjegjësitë individuale të punonjësve të AKBPM, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me qëllim nisjen e procedurave të nevojshme administrative për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do të vlerësoj marrjen e masave, nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara dhe reflektimin e tyre sa i përket, garantimit të barnave të sigurta dhe cilësore në treg, mbikëqyrjes institucionale, plotësimit dhe përmirësimit të akteve ligjore mbi të cilat bazohet veprimtaria, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike.

F. TË TJERA

Problematikat e konstatuara në këtë auditim tematik, për vetë rëndësinë e tyre, do të jenë objekt verifikimi edhe në auditimet e plotë që KLSH do të zhvilloj në vijim, pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

V- ANEKSE

Aneksi I - “Qasja dhe metodologjia e auditimit”

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT